

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL	
PROBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVË REPUBLIC OF KOSOVA	
MINISTERI I KOSOVËS VLADE KOSOVË GOVERNMENT OF KOSOVA	
Ministria e Administratës - Fushatët Lokale Administrative Lokalne Samoprave i Administracije Ministry of Local Government Administration	
Nr. Gr. No.	0203-813/1
Data Datum Date	25.07.2012



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës - Fushatët Lokale
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 23/07/2012
Nr. 0203-813

PËR: Nexhmidin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË E RREGULLORES NR. 01-013/859.

Pranuar me datë, 18.07.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administratës - Fushatët Lokale, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojnë XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministri, Pas shqyrtimit të Rregullores nr. 01-013/859 për Varrezat, Mirëmbajtjen dhe Shërbimet e Varrimit në Territorin e Komunës së Vitisë, të miratuar me datë 13.07.2012, KONFIRMON ligjshmérinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik me efekt të plotë juridik si ne vijim;

- Rregullorja nr. 01-013/859 për Varrezat, Mirëmbajtjen dhe Shërbimet e Varrimit në Territorin e Komunës së Vitisë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtoreve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së.

DALËSE-IZLAZMA-OUTGOING	
MINISTRIA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
MINISTRIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration	
Nr. Br. No.	<u>0203-813/1</u>
Data Datum Date	<u>25.07.2012</u>



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration*

Dana, 23/07/2012
Br. 0203-813

ZA: Nexhmidin Arifi, Gradonačelik Opštine Vitina
Skenderbe Hebibi, Predsedavajući Skupštine Opštine Vitina

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI UREDBE BR. 01-013/859.

Primljeno dana, 18.07.2012

Poštovani-a

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandator odredjenog po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Vladine Uredbe 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, Posle razmatranja Uredbe br. 01-013/859 o groblju, održavanje i usluge sahrane na teritoriji opštine Vitina, usvojene dana 13.07.2012, POTVRDJUJE zakonitost ovog akta i ocenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu


Pravni Akt sa punim pranim efektom, kako sledi ;

- Uredba br. 01-013/859 o groblju, održavanje i usluge sahrane na teritoriji opština Vitina .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-e,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e
*Direktprijava uprava i kancelarija
Arhivi MALS-e.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Data: 18.07.2012			
Nr. i organit Organ's No.	Nr. i llojtit Type No.	Ditese Date	Vlera Value
01-013	859	III	0203-813

Komuna e Vitise
Opština Vitina

0203-813

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2. pika c. të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, si dhe nenit 11, paragrafi 11.2. pika p. të Statutit të Komunës së Vitise nr. 01-013/191 i datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës më 13.07.2012 miraton këtë:

RR E GULL O R E

PËR VARREZAT, MIRËMBAJTIJEN E TYRE DHE SHËRBIMET E VARRIMIT NË TERITORIN E KOMUNËS SË VITISE.

Dispozitat e përgjithshme:

Neni 1

- 1.1. Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e rregullimit të varrezave, mirëmbajtja e tyre dhe shërbimet e varrimit në territorin e Komunës së Vitise.
1.2. Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave është veprimtari komunal me interes të përgjithshëm.

Përkufizimi:

Shpjegime të kuptimeve të fjalëve që përdorën në këtë rregullore:

Varr (vendi për varrosjen e trupit).

Varrimi (vendosje e kufomës në varr).

Varrezë (është toka e caktuar për varrin e përcaktuar sipas planit urbanistik të qytetit).

Shfrytëzuesi i vend-varrit (personi i cili përkufijdeset për vend-varr).

Leje për zhvarrosje (leje të cilën e lëshon Kuvendi Komunal për zhvarrosjen e të vdekurit).

Prekje (pushimi shpirtëror i të vdekurit).

Kontraktuesi-Kompania (subjekti i përzgjedhur për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave).

Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave:

Neni 2

Kregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave nënkupton rregullimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe mjezeve të cilat shërbejnë për kryerjen e shërbimit të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, hapësirave ndërmjet varreve, mirëmbajtja e gjelbërimit, rendit dhe pastërtisë, largimit të borës dhe akullit, përgatitjen e hapësirës për varrim si dhe kryerjen e punëve të tjera të cilat janë të lidhura me rregullimin dhe mirëmbajtjen të varrezave-varreve në veçanti.

Neni 3

Në qytet si dhe vendbanime tjera ne territorin e Komunës së Vitisë, duke ditur se jetojnë ndërsa në vendbanime tjera të territorit të Komunës në përputhje me planin zhvillimor Urban, pjesëtarë të konfesioneve të ndryshme, mund të janë dy ose shumë lokacione për varreza.

Neni 4

- 4.1. Toka- lokacioni për varreza në qytet caktohet në përputhje me Planin Zhvillimor Urban, ndërsa në vendbanime tjera të territorit të Komunës në përputhje me planin komunal zhvillimor
- 4.2. Para caktimit të vendit-lokacionit për varreza duhet pasur kujdes veçanërisht në mbrojtjen e burimeve dhe puseve prej nga banorët furnizohen me ujë.

Neni 5

Lokacioni apo vendi i varrezave caktohet me vendim të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 6

- 6.1. Në bazë të projektit detal të varrezave, hapësira në varrezat e dedikuara për varrosje ndahet në parcela, në brendi të cilat ndodhën vendet për varrim të cilat evidentohen me numra.
- 6.2. Kontraktuesi është i obliguar që të udhëheq dhe evidentoj nga strati dhe vendet e varrit me emrin e personave të vdekur, datën e varrimit si dhe shërbime të tjera lidhur me varrimin.

Neni 7

- 7.1. Varrezat rrethohen sipas projektit të paraparë. Komuna është e obliguar në afat prej një viti nga dita e hyrjes ne fuqi të kësaj rregullore të bëjë rrethimin e varrezave të qytetit.
- 7.2. Mjetët e nevojshme për ndërtimin dhe rregullimin e rrethojave sigurohen nga buxheti Komunal dhe burimet e tjera (donatorët e mundshëm).

Neni 8

- 8.1. Komuna bazuar në procedurat e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin përzgjedh përfituesin i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të qytetit dhe fshatrave .
- 8.2. Kontraktuesi i kryen shërbimet sipas dispozitave të kësaj rregullore në përputhshmëri me çmimet propozuara nga Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe G.E dhe të aprovuara nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Neni 9

9.1.Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave bëhet në bazë të programit vjetor, të cilin e propozon Drejtoria për Shërbime Publike dhe G.E, e të cilin e miraton Kuvendi i Komunës.

9.2.Përkuqdesje të veçantë do t'i kushtohët varrezave të dëshmoreve,dhe qytetit të Vitisë.

Neni 10

10.1.Me mirëmbajtjen e vendeve të varrimit përkujdesët shfrytëzuesi apo familja e afërt dhe farefisi.

10.2.Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrit shfrytëzuesi mund tu a besojë kontraktuesit i cili mbikëqyrë varrezat.

10.3.Për shfrytëzimin e vendvarrimit dhe shërbimeve në lidhje me varrosjen paguhën shpenzimet. Lartësia e kompensimit për shërbimet e varrimit caktohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe G.E.

Neni 11

11.1.Kontraktuesi gjatë mirëmbajtjes duhet domosdo tu përmbahet rregullave dhe projektit të varrezave.

11.2.Ndërtimi mbi varre lejohet në forma dhe madhësi të njëjtë të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. mbi bazën e propozimit paraprak të Këshillit të Bashkësisë Islame dhe Bashkësive tjera fetare në Komunën e Vitisë.

11.3.Shfrytëzuesi i vendvarrimit nuk mundë shfrytëzimin e vendvarrimit ta bartë te personat e tjerë, ndërsa në rast të vdekjes së bartësit të së drejtës së shfrytëzimit kjo e drejt i takon trashëgimtarit të tij të shpallur, e nëse ka më tepër trashëgimtarë ata janë të detyruar ta zgjedhin trashëgimtarin e tyre të përbashkët.

11.4.Kontraktuesi(Kompania) të cilës iu është besuar ta kryej veprimtarinë e varrosjes dhe bashkësitetet fetare përkatëse janë të detyruara të mbajnë evidencën e personave të varrosur, vendeve të varreve dhe shfrytëzuesve të vendvarrimeve.

11.5.Me evidencën nga alineja 3 e këtij nenit njoftohet sektori i gjendjes civile në Komunë.

11.6.Evidenca e të vdekurve duhet të arkivohet te bashkësia përkatëse fetare dhe ka karakter të gjatë arkivimi.

11.7.Ndryshimet eventuale mund ti bëjë kontraktuesi vetëm me pëlqimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të mjedisit.

Neni 12

Të drejtat dhe përgjegjësitet e kontraktuesit përcaktohen me konratë të veçantë.

Neni 13

13.1.Për vendosjen, riparimin dhe zhvendosjen e pllakave dhe mjeteve tjera në vendet e varrimit është i obligueshëm pëlqimi i organit përkatës.

13.2.Për ndërmarrjen e çfarëdo pune në lapidar (pllakë përkujtimore) ose ndonjë pjesë në varrë ose varreza e cila ka karakterin e lapidarit kulturor është i nevojshëm pëlqimi me shkrim nga institucioni i cili merret me mbrojtjen e monumenteve kulturore.

13.3 Materialet ndërtimore (rëra, cimenta etj) është e lejuar të mbahen në varreza për një kohë sa ma të shkurtë e cila është e nevojshme për kryerjen e punëve në varreza, pas mbarimit të punëve ekzekutuesi është i obliguar që menjëherë vend punimin ta kthej ne gjendjen e më pashme.

13.4. Nëse gjatë kryerjes së punës gjinden arkivole dhe gjëra tjera me vlerë, puna duhet të ndërpritet dhe menjëherë duhet te lajmërohet kontraktuesi.

13.5. Ekzekutuesve të punëve të cilët nuk i përbahen dispozitave të këtij nenit, udhëzimit për respektimin e rendit në varreza, Drejtoria e Inspepcionit ju ndalon aktivitetin ndërtimor në varreza.

Neni 14

14.1. Në varreza është e lejuar mbjellja e luleve dekorative të rritjes së ultë të cilat nuk i pengojnë varret e tjera përreth.

14.2. Në varreza është e ndaluar ngritura dhe vendosja e simboleve dhe shenjave të tjera, të cilat nuk janë në lidhje me personat e varrosur në varreza.

14.3. Eshtë e ndaluar vendosja e simboleve, përmendoreve në vendvarrime të cilat me dukjen, shenjat apo mbishkrimet ofendojnë ndenjet patriotike, fetare, nationale dhe ndenja tjera të qytetarve.

Neni 15

15.1. Kontraktuesi që menaxhon me varrezat e qytetit të Vitisë është i obliguar që aktivitetet të jenë në pajtueshmëri me projektin e aprovuar për rregullim të varrezave.

15.2. Në bazë të projektit detal të varrezave të bëjë përcaktimin e vendeve për varrim, t'i mirëmbajë rrugët, hapësitrat ndërmjet varreve, të kujdesët për mirëmbajtjen dhe mos dëmtimin e rrëthojave, përkujdesje të veçantë t'i kushtojë varrezave të dëshmorëve, t'i kryej shërbimet lidhje me varrimin dhe transportin, të mbaj librin amë të varrimit, posaçërisht për secilin varr me përshkrim të hollësishëm të vendit, të mbaj evidencën e varrezave, lapidarëve, të kryejë edhe punë tjera në mirëmbajtje, rregullim dhc mbrojtje të varrezave të cilat përcaktohen me kontratë.

Varrimi :

Neni 16

16.1. Me varrim nënkuftohet varrosja e të vdekurit, përkatësisht vendosja e eshtrave të kufomës në vendet e caktuara.

16.2. Varrosja bëhet pasi të jetë konstatuar vdekja e përcaktuar me dispozita ligjore.

Neni 17

17.1. Pas konstatimit të vdekjes nga ana e mjekut, familja përkatësish personi që përkujdesët për varrosje është i obliguar që në afatin prej 3 orësh ta njoftoj kontraktuesin për vdekjen e personit me qëllim të organizimit të bartjes dhe varrosjes në varreza të qytetit.

17.2. Organizimin kompleti të varrimit që nga bartja e bënë kontraktuesi që menaxhon me varreza.

Neni 18

18.1. Punët e shërbimit të varrimit i kryen kontraktuesi të cilës komuna ja ka besuar këto shërbime.

18.2. Kontraktuesi është i obliguar të siguroj personelin për shërbime të varrimit, bartjen e kufomës çdo ditë prej orës 7 deri 20. Bartja duhet bëhet të njëjtën ditë kur nga ana e mjekut është konstatuar vdekja.

Neni 19

19.1.Varrosja e kufomës së të ndjerit (të vdekurit) bëhet në varrezat e vendbanimit të caktuar në të cilin i vdekuri në momentin e vdekjes ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin.

19.2.Vendi për varrim i jepet në shfrytëzim farefisit të të ndjerit dhe atë bashkëshortit të të ndjerit/ndjerës me kurorë, jashtë kurorës, fëmijës legjitim apo të falur (adaptuar), prindërve të të ndjerit.

19.3.Kuvendi Komunal do t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për qytetarët të cilët nuk kanë farefis dhe nuk kanë qenë nën përkujdesjen e askujt, si dhe rastet sociale ekstreme.

Neni 20.

20.1.Kufoma bartët për në varrë me arkivol nga të afërmët dhe farefisi apo nga kontraktuesi me mjete të caktuara motorike për këtë qëllim.

20.2.Gjatë bartjes së kufomës së të ndjerit në varreza ku duhet të varrosët, duhet të plotësohen kushtet sanitare-teknike dhe i ndjeri varrosët sipas riteve dhe dokeve fetare të bashkësive përkatëse fetare.

Neni 21

21.1.Nëse varrmin e organizon Komuna apo Kuvendi Komunal i saj, kufomat e njërzve meritor para varrimit mundën të vëhën në vendin e caktuar jashtë varrezave, me qëllim të dhënies së nderimeve të fundit.

Neni 22

22.1.Varrosja bëhet ne pajtim me dispozitat rregullat fetare duke respektuar dinjitetin e të vdekurit.

22.2.Kufoma e të vdekurit nuk mund të zhvarrosët apo të bartën nga varrezat ekzistuese para skadimit të afatit të obligueshëm sanitari i cili është spaku 10 vjet.

Neni 23

23.1.Mihja dhe mbushja e varrit, përkatesisht mbyllja e varrit në varrezat e qytetit bëhet nga kontraktuesi.

23.2. Ndërsa në vendbanime tjera –fshatra këto punë u besohen bashkë familjareve të të ndjerit ose personave tjercë.

Neni 24.

24.1.Bashkë me kërkesën për varrim ose bartjen e eshirave të kufomës paraqitësi i kërkesës është i obliguar të paraqesë dëshmi mbi pëlqimin e bashkë familjareve më të afërt të të ndjerit ose personit të autorizuar për shfrytëzin e varrit.

24.2.Për bartjen e eshirave nga një varrë dhe varrosja në varreza tjera për qëllime në interes të Komunës, novojitet leja nga Kuvendi Komunal dhe Drejtoria për Inspektion, Inspektori sanitari i bazuar në dispozita ligjore që rregullojnë këtë lëmi.

24.3.Pas mbarimit të ceremonisë së varrimit, përkatesisht varrosjes, personeli që ka kryer punët është i obliguar që vendin e varrit ta rregullojë sipas dispozitave të kësaj rregulllore.

24.4. Shpenzimet e varrimit i sigurojnë familja, të afërmit e tij ose personi i cili ka qenë i obliguar ta mbajë ose që ka pasur përkujdesje për të ndjerin.

Neni 25

- 25.1. Varrosja e kufomës së të ndjerit bëhet në varrezën e cila është në shfrytëzim të rregullt.
25.2. Përfjashtimi i jashtë varrezave të cilat janë në përdorim mund të bëhet varrimi vetëm me lejen e organit kompetent të administratës komunale dhe bashkësisë fetare përkatëse.

Neni 26

- 26.1. Nëse në varrezat ekzistuese nuk ka vend për varrim për shkak të zgjerimit të vendbanimit për arsyec sanitare ose varrezat ekzistuese nuk i përgjigjen kushteve, Kuvendi i Komunës bien vendim se varrezat e tillë pushojnë të janë në funksion të përdorimit.

26.2. Vendimi nga alineja 1 e këtij nenit, Kuvendi i Komunës e bien në bazë të të dhënave të komisionit të posaçëm profesional.

Neni 27

- 27.1. Varrezat të cilat konsiderohen jashtë përdorimit, pas skadimit të afatit për përdorim mund të shndërrohen në park ose brez gjelbërimi me vendim të veçantë të Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 28

28.1. Varret mund të janë varre personale dhe varre familjare.

28.2. Në varret për person varrosojt vetëm një person, ndërsa në varret familjare varrosojnë të afërmit e gjakut, me kusht që thellësia e varrit deri në skajin e sipërm të arkivolit të jetë së paku 0.90 m.

Rendi në varreza:

Neni 29

29.1. Në varreza mbahet rendi dhe qetësia absolute. Kontraktuesi është i obliguar që të sigurojë qetësin absolute në varreza.

29.2. Varrezat janë të hapura për vizitorë çdo ditë pune dhe atë për periudhën prej:

1 prillit deri më 30 shtator prej orës 07.00 deri ora 19.00

1 tetor deri më 31 mars prej orës 07.00 deri ora 18.00

29.3. Kontraktuesi me pëlqimin të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ne raste te jashtëzakonshme dhe të arsyeshme, përkohësisht mund të bëhet ndalesën për vizitorët në varreza.

Neni 30

30.1. Vizitorët, shfrytëzuesit e vendvarrimit janë të obliguar t'i përrmbahen urdhëresës, udhëzimeve të cilat i jepin personat e autorizuara.

30.2. Vizitorët janë të obliguar të mbajnë qetësi gjatë vizitave në varreza e cila u përgjigjet dinjitetit dhe obligimit ndaj të ndjerëve.

Neni 31

- 31.1.Në varreza janë të ndaluar këto sjellje, si:
31.2.Hyrja dhe dalja e vizitorëve jashtë kohës kur varrezat janë të hapura për vizitor, hyrja e fëmijëve nën moshën 10. vjeçare pa përcjelljen e personave të rritur.
31.3.Kalimi i rrëthojave, shkelja e sipërfaqeve të gjelbëruara, thyerja e drurëve, këputja e luleve dhe bimëve tjera dekorative, shkelja njollosja dhe dëmtimi i vendeve të varimit.
31.4.Prishja e qetësisë në varreza.
31.5.Futja dhe kulloja e kafshëve në varreza;
31.6.Montimi i ulëseve, rrëthojave nëse nuk janë paraparë në projekt.
31.7.Mbjellja e drurëve për rrëth varrit pa pëlqimin Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

MJETET E NEVOJSHME PËR KRYRJEN E SHËRBIMEVE

Neni 32

- 32.1.Mjetet për ndërtim, rregullim dhe mirëmbajtje të varrezave sigurohen nga buxheti komunal si dhe nga burimet tjera (donatorët), në përputhshmëri me dispozitat ligjore.
32.2.Mjetet për kryerjen e shërbimeve për varrim sigurohen nga çmimi të cilët e paguajnë shfrytëzuesit e së drejtës për varrim.
32.3.Çmimin e tarifës për varrime e cakton Kuvendi Komunal me propozim të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe G.E.

Neni 33

- 33.1.Për rregullim, mirëmbajtje të objekteve në varreza, si dhe shfrytëzimin e shërbimeve në varreza (mirëmbajta e trugëve, hapësira në mes të vend varreve, gjelbërimi, ndricimi publik, rendit dhe pastërtisë) shfrytëzuesi paguan kompensim për shfrytëzim të vend varrit.
33.2.Kompensimin e shpenzimeve të varrimit për personat e vdekur të cilët janë të pa identifikuar ose të cilët pas vetës nuk kanë lënë asnjë të afërm e bënë Kuvendi i Komunës nga buxheti i vetë, përkatësish komuniteti i vendbanimit.

Të drejtat dhe përgjegjësit e Kuvendit të Komunës

Neni 34

- 34.1.Në raste të jashtëzakonshme kur vjen deri te çrrregullimi ose ndalimi i kryerjes së punëve në rregullim dhe në mirëmbajtje të varrezave për shkak të fatkeqësive natyrore kontraktuesi është i obliguar që menjëherë pa hezitim të ndërmarr aktivitete në eliminimin e shkaktarit të çrrregullimit dhe atë:
a). Ngazhon persona që të evitohen shkaqet që çrrregullojnë mirëmbajtjen dhe varrimin në varreza,
b). Urgjentisht riparon dhe ndërron instalimet dhe mjetet të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e punëve,
c). Propozon masa për eliminimin e pasojave, vërteton shkaqet si dhe përgjegjësit për kompensimin e dëmeve.
d). Ndërmerr edhe masa tjera të cilat i përcakton Drejtoria për Shërbime Publike dhe G.E.

Masat ndëshkuese

Neni 35

35.1. Shkelja e dispozitave të kësaj rregullore konsiderohet kundërvajtje, sipas parimit të legalitetit.

35.2. Me dënim në të holla në lartësi prej 300 euro deri në 1.500 euro do të dënohet për kundërvajtje kontraktuesi (kompania) nëse:

- a). Nuk siguron bartjen e kuromës së të ndjerit,
- b). Pa arsyesh refuzon ta lëshoj vendvarrimin për varrosjen e kuromës së të ndjerit,
- c). Rregullisht nuk mban evidencën e personave të varrosur me shënimë të nevojshme,
- d). Nëse nuk rregullon, nuk kryen mirëmbajtjen dhe nuk mbron varrezat ne pajtim me dispozita të kësaj rregullore.

f). Nëse jep pëlqimin për kryerjen e punëve pa lejen paraprake të organit kompetent.

35.3. Ndërsa me dënim në të holla (gjobë) mandatore, aty për aty nga Inspektioni në lartësi prej 50 Euro deri 100 Euro do të dënohen për kundërvajtje të gjithë ata persona që shkelin këtë rregullore.

35.4. Kontraktuesi (kompania) e cila menaxhon me varreza për kundërvajtje do te gjobitet pre 500 deri 1000 Euro nëse:

- Vepron ne kundërshtim me nenin 6, alineja 2 të kësaj rregullore,
- Vepron ne kundërshtim me nenin 9, alineja 1 të kësaj rregullore,
- Vepron në kundërshtim me nenin 11 të kësaj rregullore,
- Vepron në kundërshtim me nenin 15 të kësaj rregullore.

Neni 36

36.1. Në shumë prej 1000 deri në 1500 Euro do të ndëshkohet personi juridik për kundërvajtje, nëse ekzistojnë shërbimet zejtare të ndaluara sipas nenit 13 të kësaj rregullore.

36.2. Personi përgjegjës (kontraktuesi) do të gjobitet për kundërvajtje prej 100-300 Euro, nëse vepron ne kundërshtim me nenin 13.

36.3. Kontraktuesi do të gjobitet për kundërvajtje prej 300-500 Euro, nëse vepron ne kundërshtim me nenin 13, alineja 3 dhe 4.

Neni 37

Personi fizik do të gjobitet prej 100-200 Euro për kundërvajtje nëse vepron në kundërshtim me nenin 13 të kësaj rregullore.

Neni 38

38.1. Personi juridik do të gjobitet në shumë prej 500 Eurosh për kundërvajtje nëse zhvillohen aktivitetetë në varreza pa pëlqimin e përfituesit që menaxhon me varreza.

38.2. Ndërkaq te personi përgjegjës do të gjobitet me kundërvajtje ne shumen 250 Euro.

38.3. Personi fizik do të gjobitet ne shumën 100-250 Euro nëse vepron ne kundërshtim me nenin 33 të kësaj rregullore.

38.4.Nëse nuk kryen obligimet konform kësaj rregullore, Drejtoria për Inspektion do të ngrit procedurë për kundërvajje në Gjykatën Komunale në Viti.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare:

Neni 39.

39.1.Për zbatimin e kësaj rregullore përgjegjës janë: Drejtoria për Buxhet Financa dhe Zhvillim Ekonomik,Drejtoria për Shërbime Publike dhe G.E. si dhe Drejtoria për Inspektion dhe kontraktuesi i cili menaxhon në varrezat e qytetit.

Neni 40

40.1.Në rast të zbratzësirave juridike do të vlefjnë drejtpërsëdrejti dispozitat pozitive ligjore të kësaj lëmie.

Hyrja në fuqi :

Neni 41

41.1.Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, si dhe nënshkrimin nga ana e Kryesuesit të Kuvendit komunal.

Më 13.07.2012
VITI

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Skenderbe Hebishi /